

V E N D I M
Nr.207, datë 28.4.1999

PËR NDARJEN DHE RISTRUKTURIMIN INSTITUCIONAL TË FONDIT TË ZHVILLIMIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 544, datë 29.7.1998 "Për riorganizimin institucional të Fondit të Zhvillimit Shqiptar", me propozimin e zëvendëskryeminsitrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Nga struktura administrative e Fondit të Zhvillimit Shqiptar të shkëputen departamenti i kredisë rurale, departamenti i kredisë urbane dhe departamenti i mbështetjes veterinare. Fondi i Zhvillimit Shqiptar do të vazhdojë si institucion i specializuar në projektet e infrastrukturës së vogël, lokale. Veprimtaria e tij do të jetë në përputhje me statusin, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Krijimin e fondacionit "Fondi i Financimit Rural", si institucion tranzitor, për mbështetjen teknike e financiare të krijimit të sistemit të shoqërive kursim-kredi dhe unionit të tyre. Veprimtaria e tij do të jetë në përputhje me statusin, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Veprimtaria, fondi i kredisë dhe asetet fikse të departamentit të kredisë rurale, të FZSH-së të transferohen në formë granti në Fondin e Financimit Rural, sipas marrëveshjes, që do të lidhet për këtë qëllim ndërmjet Ministrisë së Financave, FZSH-së dhe Fondit të Financimit Rural.

4. Të transferojë veprimtarinë, asetet fikse në formë granti, fondin e kredisë në formën e blerjes, sipas termave të zbatuara nga Banka Botërore (Nëse pas një periudhe 4-vjeçare do të arrihet realizimi i të gjithë treguesve të përcaktuar në marrëveshje, ky fond do të kalojë si kontribut i qeverisë shqiptare, në formën e grantit në fondacionin "Besa") nga departamenti i kredisë urbane të FZSH-së te fondacioni "Besa", sipas marrëveshjes, që do të lidhet për këtë qëllim ndërmjet Ministrisë së financave, FZSH-së dhe fondacionit "Besa".

Forma dhe mënyra e monitorimit të treguesve përcaktohet në këtë marrëveshje.

5. Veprimtaria dhe asetet fikse të departamentit të mbështetjes veterinare të FZSH-së, t'i transferohen një organizate joqeveritare, me të njëjtën natyrë veprimtarie, sipas një marrëveshjeje, që do të lidhet për këtë qëllim, ndërmjet Ministrisë së financave, FZSH-së dhe OJQ-së. Transferimi i aseteve fikse të bëhet në formë granti.

6. Transferimi faktik i veprimtarive dhe i aseteve, në të gjitha rastet e mësipërme, të bëhet vetëm pas vlerësimit të tyre nga një kontroll financiar i pavarur.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe Fondi i Zhvillimit Shqiptar për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko